


Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit: Komuna Prizren	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
	OE ankues: “Renelual Tahiri” dhe “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi”		307/19 321/19
Prej:	 Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e parashtruara nga OE “Renelual Tahiri” – Prizren dhe ankesën e OE “G-Solutions&G-Project&Joos Krasniqi” – Prizren.		
Datë	04.07.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës: 13.06.2019, me nr. 307/19 të parashtruar nga OE “Renelual Tahiri” – Prizren dhe ankesën e datës: 17.06.2019, me nr. 321/19 të parashtruar nga OE “G-Solutions&G-Project&Joos Krasniqi” – Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara ne Komunën e Prizrenit”**, me numër të prokurimit: **622-19-1256-1-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Prizren**.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:


- Autoritetit Kontraktues – KOMUNA PRIZREN.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – RENELUAL TAHIRI dhe G-SOLUTIONS&G-PROJECT & JOOS KRASNIQI.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e parashtruara nga OE-të ankues, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara ne Komunën e Prizrenit”**, me numër të prokurimit: **622-19-1256-1-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Prizren**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		19.06.2019	04.07.2019
Nënshkrimi i ekspertit		data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 13.06.2019, OE “Renelual Tahiri” - Prizren, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Euro Via” - Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara ne Komunën e Prizrenit”**, me numër të prokurimit: **622-19-1256-1-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Prizren**.

Me datën: 17.06.2019, OE “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi” - Prizren, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Euro Via” - Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara ne Komunën e Prizrenit”**, me numër të prokurimit: **622-19-1256-1-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Prizren**.

Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatoret Ekonomik Ankues:

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e OE “Renelual Tahiri” - Prizren, janë të njëjta me kërkesën për rishqyrtim.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e OE “G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi”, janë të njëjta me kërkesën për rishqyrtim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e parashtruara nga OE-të ankues, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara ne Komunën e Prizrenit”**, me numër të prokurimit: **622-19-1256-1-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Prizren**.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e njoftimit të dhënies së kontratës dhe refuzimit të kërkesës për ri-shqyrtim për aktivitetin e prokurimit : "Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit." me nr. të aktivitetit të prokurimit: 622-19-019-111. ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenëve të LPP-së si më poshtë:

Neni 1,

Neni 6,

Neni 7,

Neni 10,

Neni 53,

Neni 59,

Neni 60,

Neni 69,

Neni 72,

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne si OE i interesuar për këtë aktivitet të prokurimit ashtu kemi aplikuar për këtë aktivitet të prokurimit me dt. 30.04.2019 dhe kemi dorëzuar ofertën tonë e cila sipas AK nuk ka qenë e përgjegjshme me arsyetimin sipas letrës standarde për tenderuesit e pa sukseshmë në ofertën tonë mungojnë "Projektet e natyrës së kontratës realizuar në tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të njoftimit) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera

minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.500.000 euro"nga AK me dt.31.05.2019 kemi pranuar njoftimin për eliminimin përmes kësaj letrë standarde për tenderuesit e pa sukseshëm.

Me dt.03.06.2019 kemi parashtuar kërkesë për ri-shqyrtim me pretendimin ankimor se AK me rastin e eliminimit tonë nga aktiviteti i prokurimit:"Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit."me nr.të aktivitetit të prokurimit:622-19-019-111.ka shkel dispozitat e nenit 1,6,7,10,53,59,60,69 dhe 72 të LPP-së sepse ne kemi plotësuar kërkesat e DT dhe NJK lidhur me projektet e realizuar në tri vitet e fundit,po ashtu AK nuk ka dhënë sqarime shtesë lidhur me kërkesën tonë drejtuar AK me dt.03.04.2019 dhe nuk ka dëshmi të mjaftuar se OE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar me referencë aktivitetin e prokurimit me nr.622-15-319-111 të dëshmuar me procesverbalet dhe pagesa në bankë.

AK me dt.06.06.2019 merr vendim me të cilin refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim se komisioni i vlerësimit ka llogarit të gjitha referencat e natyrës së kontratës dhe kjo listë me këto shuma nuk arrin ta plotësoj vlerën e kërkuar dhe arsye e dytë e këtij vendimi se kemi pranuar informata nga komisioni se cilat referenca pranohen.

Po ashtu me të njejtën datë me 31.05.2019 përmes letrës standarde për tenderuesit e sukseshm njoftohemi se tenderues i sukseshëm për këtë AK është OE"Eurovia"Shpk.

Konsiderojm se lidhur me këto veprime Autoriteti Kontraktues Komuna e Prizrenit ka bërë:

- Shkelje esenciale të dispozitave të LPP-ës dhe
- Vërtetim të gabuar të gjendjesë faktike.

Ne si OE pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nuk pajtohemi me vendimin e AK lidhur me arsyet e cekura në këtë vendim.

AK me këtë vendim ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 53 të LPP-së sepse pas kërkesës tonë të dt.03.04.2019 për informacione shtesë se cilat referenca prahohen të njejtit vetëm rekomandojnë që të keni parasysh kriteret e DT dhe NJK.

Nga paramasa e DT ne kemi gjetur se gati fare pak kemi të bëjmë me furnizim me zhavor për këtë aktivitet të prokurimit,por kemi të bëjmë me betonim armim vendosje të gypave,hapja e kanaleve,transporti i makinerive,ndërtim i murit mbrojtës,nga kjo paramas gjejmë vetëm tri pozicione ku kemi të bëjmë me furnizim me zhavor ndërsa pozicionet tjera kemi të bëjmë me punë,për këtë ne kemi shprehur shqetsimet lidhur me referencat sepse AK ka kërkuar furnizime me zhavor në vlerë prej 1.500.000 euro.

Nëse shiqojmë ofertat e OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit gjejmë se vetëm OE i rekomanduar për kontratë ka "plotësuar"me dyshime kërkesat e AK.

Kjo është bër me qëllim të caktuar dhe paraprakisht është ditë rezultati se kush është i preferuari i AK për tu rekomanduar për kontratë.

Nëse shiqojmë listën e kontratave dhe referencat nga oferta jonë gjejmë po thuajse paramasat identike me ato për këtë aktivitet të prokurimit,ne nuk kuptojmë akoma se qka kanë dëshiruar AK me furnizim me zhavor a kemi të bëjmë vetëm furnizimi,grumbullimi i zhavorit në një vend të caktuar dhe sa ashtë e vlersueshme dhe domethanë,e rëndësishme kërkesa prej 1.500.000 euro referenca me këtë vlerë për furnizim me zhavor,sa komplekse është ky aktivitet i prokurimit të kërkohe kërkesa të tilla por një e vërtet se këtu kemi të bëjmë me dyshime të bazuara për kurdisje të tenderit.....!

Si ka mundësi që nga një mal me referenca që kemi ofruar AK nuk i merr parasysh kur me mijra herë është ma komplekse ndërtimi i rrugëve ku për ndërtimin e saj nevojitet edhe zhavor, pastrim tereni, ngjeshje, betonim armim asfaltim etj, etj se një furnizim me zhavor, këto rrugë që janë ndërtuar a kan sasi dhe të zhavorit apo jan ndërtuar me pambuk që AK nuk i pranon referencat është për keqardhje dhe është nevritëse veprimet e AK.

Në përgjigjen e dytë të AK lidhur me kërkesën për ri-shqyrtim vetëm tërthorazi përmendet se rekomandimi i komisionit ka qenë referoju DT dhe NJK se cilat referenca pranohen. Sikur AK të jepte përgjigje konform nenit 53 ne do të shqyrtonim pozicionin tonë se duhet të marrim pjesë në këtë aktivitet të prokurimit edhe ashtu i destinuar paraprakisht për OE "Eurivia".

Andaj ne nuk pajtohemi me eliminimin nga ky aktivitet i prokurimit, arsyet e cekura nga AK janë të pa vërteta, jo profesionale dhe irituese sepse nga këto shifet tendencë për eliminim dhe shpërblim me kontratë OE të caktuar.

Nga kjo shifet qartë se AK ka dështuar me rastin e vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderve në atë mënyrë duke bërë shkelje të dispozitave të lartë cekura të LPP-së nga kjo mund të konkludojmë se vlersimi ka qenë subjektiv dhe jo profesional i ofertave dhe!!!!

Nga kjo që u tha më lartë gjejmë se AK me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit e kanë përcjell një sërë shkelje të njëpasnjëshme gjatë vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderve duke anashkaluar qëllimin dhe parimet e prokurimit publik për të cilën AK është i thirrur dhe obliguar të zbatoj sipas ligjit.

Me këtë rast AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 gjatë vlerësimit të tenderëve sepse nuk ka përdor nenit 59.2 dhe 59.4 kur kemi të bëjmë me ofertë me qmim më të ulëtë e cila ndërlihet me nenin 72 të po këtij Ligji.

AK me eliminimin tonë si OE të cilit kemi pas ofertën tonë me qmim më të ulët ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP citat i nenit 1.1 të LPPs:

" 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".

Po ashtu edhe neni 6 i LPP-së i obligon AK të sigurojnë fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike citat i nenit 6 të LPP-së:

" Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion

sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Bazuar në të gjeturat mund të konkludojmë se AK nuk ka pas qëllim e ruajtjes së paras publike, ka vepruar në kundërshtim me parimet në të cilat mbështetet prokurimi publik, veprimet e AK qojnë në shkelje të kriterëve të cilat vetë AK i ka parashikuar në DT dhe njoftimin për kontratë jo transparenca ka qenë evidente tek vlersimi i ofertave dhe përgjegjja lidhur me kërkesën për informacione shitesë, AK gjatë tërë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka qenë i një anshëm dhe veprimet e tyre janë diskriminuese dhe favorizuese për OE të caktuar duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 të LPP-ës.

Andaj kërkoj nga Organi Shqyrtues i Prokurimit si institucion autoritativ që me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese për aktiviteti i prokurimit: "Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit." me nr. të aktivitetit të prokurimit: 622-19-019-111 të mer këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "Renelual Tahiri" nga Prizreni lidhur me aktivitetin e prokurimit për tenderin "Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit." me nr. të aktivitetit të prokurimit: 622-19-019-111.

2. Anulohet vendimi i AK për eliminim të OE "Renelual Tahiri" nga Prizreni lidhur me aktivitetin e prokurimit për tenderin "Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit." me nr. të aktivitetit të prokurimit: 622-19-019-111 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

*Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë humbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar,
Shpenzimet e përgaditjes së tenderit,
Sigurimi i tenderit,
Shpenzimet e ankesës.
Largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në prespektiv dhe imazh të kompanisë tonë
Fitimi i planifikuar për këtë tender*

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Me datën 04.06.2019 është parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, me këto pretendime ankimore:

- Nuk janë marrur për bazë kontratat e ofruara si dëshmi/punë referente nga Komisioni për Vlerësimin e Tenderëve;
- Mos plotësimi i çmimit total të ankesës nga konsorciumi ynë nuk përbën shkelje esenciale të Ligjit të Prokurimit Publik, dhe në përputhje me vendimet paraprake të Organit Shqyrtues të Prokurimit, konsiderohet si një devijim i vogël, sidomos kur çmimi i ofertës është më i ulët;
- Operatori ekonomik i rekomanduar për shpërblim me kontratë është i papërgjegjshëm për shkak se makineria dhe mjetet e punës nuk janë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, apo nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për disa pajisje se janë në përputhje me dosjen e tenderit. Po ashtu një pjesë e makinerisë së këtij operatori ekonomik nuk kanë patur në ofertë librezën e regjistrimit, përkundër se ka qenë kërkesë eksplicite e dosjes së tenderit.

Kjo kërkesë për rishqyrtim është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues, pa e bërë verifikimin faktik të pretendimeve ankimore.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji i Prokurimit Publik (LPP)

- Neni 1 = Qëllimi i Ligjit të Prokurimit Publik
- Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 – Barazia në Trajtim/Jo diskriminimi
- Neni 10 – Mjetet për promovimin e transparencës
- Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RrUOPP)

- Neni 4 – Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit
- Neni 39 – Sqarimi i tenderëve

Vendimet paraprake të Organit Shqyrtues të Prokurimit

- Vendimi 104/18
- Vendimi 197/16

- Vendimi 448/15
- Vendimi 193/18

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në aktivitetin e prokurimit "Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara të Komunës së Prizrenit", Autoriteti Kontraktues ka bërë shkeljen e shtatë (7) neneve të Ligjit të Prokurimit Publik dhe të paktën dy (2) neneve të RrUOPP, pasi që ka eliminuar ofertën e konsorciumit tonë e cila ishte më e lira në këtë proces dhe ka shpërblyer operatorin tjetër i cili ishte ofertë pesë (5) herë më e shtrenjtë sesa oferta e kompanisë tonë (sipas çmimit total).

Konsorciumi G-Solutions, G-Project dhe Joos & Krasniqi-Baze (tutje, Konsorciumi) është ofertë e përgjegjshme, pasi që ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

1. Autoriteti Kontraktues (AK) ka eliminuar ofertën tonë mbi bazën e dy arsyeve: a) nuk është plotësuar çmimi total i peshuar i ofertës, por ishte shënuar çdo çmim për njësi dhe çmimi total i ofertës. Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në tri (3) vendime të mëparshme kishte gjetur se edhe nëse çmimi total nuk është i kalkuluar, AK mund ta kalkulojë vetë këtë çmim. Me rëndësi sipas OSHP-së është të jenë çmimet për njësi të vendosura. Këto vendime janë: 104/18, 197/16, 448/15. Duke marr parasysh se paramasa është me sasi 1, dhe kontrata do të lidhet me çmim për njësi, çmimi i peshuar është krejtësisht i parëndësishëm, pasi që edhe me çmim të peshuar edhe me çmim total jemi ofertë dukshëm më e lirë.
2. Funkcioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por prapëseprapë kontrata lidhet në bazë të çmimit të ofertuar (RrUOP Neni 28.14), në këtë rast çmimi i ofertës tonë në të dy variantet i peshuar ose total është çmimi më i ulët.
3. Referenca e konsorciumit nuk janë marr parasysh nga AK. AK ka kërkuar referenca në vlerë prej EUR 1.5 milion të natyrës së kontratës. Konsorciumi ynë ka vlerësuar se natyrë e njëjtë e kontratës është çdo punë e paraparë në paramasë të dosjes së tenderit. Këtu përfshihen a) furnizimi me zhavorr, b) pastrimi i terrenit, c) gjërmim i kanaleve dhe vendosje e gypave, d) furnizim me koka hyrëse dhe dalëse me beton, e) pastrimi dhe punimi i kanaleve të hapura në formë trapezi, f) furnizim me material si dhe punimi i armaturës dhe g) betonimi i mureve mbrojtëse.
4. Në përputhje me kërkesat e paramasës së dosjes së tenderit, konsorciumi ynë ka ofruar një listë me shtatëdhjetë e katër (74) projekteve, në vlerë prej EUR 12,317,677.76. Nga kjo vlerë mbi EUR 2 milion janë punë të natyrës së kontratës, siç ka kërkuar AK në dosjen e tenderit.

5. AK nuk ka kërkuar asnjë sqarim në lidhje me këto kontrata, vetëm ka vlerësuar se nuk përmbushim kushtin e referencave. Edhe pas kërkesës për rishqyrtim AK, nuk ka ndryshuar vendimin e saj për dhënien e kontratës. Neni 72 i LPP ka paraparë saktësisht mundësinë e kërimit të informatave shtesë. Me ushtrimin e diskrecionit të arsyeshëm, për të mbrojtur interesin publik, AK është dashur të bëjë një vlerësim të kujdesshëm të referencave dhe të marr parasysh kontratat dhe dëshmitë tona si referenca, apo të kërkojë paramasat dhe të bëjë vetë vlerësimin nëse arrihet shifra e kërkuar prej EUR 1.5 milion në dosje të tenderit.
6. OShP në disa vendime paraprake, duke përfshirë *vendimin 193/18* ka kërkuar nga AK që të shfrytëzoj nenin 72 dhe të kalkulojë pozicion për pozicion nëse oferta arrinë vlerën e kërkuar për referenca të natyrës së kërkuar. Në përputhje me këtë vendim OShP duhet t'i kërkojë AK-së që në rastin e këtij aktiviteti të veprojë në të njëjtën mënyrë dhe të obligojë AK që të bëjë rivlerësimin e referencave për Operatorin Ankues.

Operatori i rekomanduar për kontratë Eurovia është i papërgjegjshëm për shkak se pajisjet e saj kalojnë tonazhen e lejuar me dosje të tenderit.

7. Dy (2) cilindrat në ofertën e Eurovia janë me kapacitet mbi 10 ton. Në dosjen e tenderit janë kërkuar që njëri na këta cilindra të jetë nën 10 ton.
8. Tre (3) buldozer të Operatorit Eurovia me peshë prej 13.55, 18.55 dhe 24.45 ton, ndërsa kërkesa ka qenë që njëri nga buldozerët të jenë deri në 10 ton. Kjo kërkesë është e paplotësuar, pasi që asnjëri nga ta nuk i plotëson kërkesat e peshës.
9. Katër (4) kamion të kërkuar me peshë deri në 10 ton, nuk është plotësuar, pasi që të gjitha pajisjet e regjistruara e tejkalojnë dukshëm peshën prej 10 ton, edhe sipas librezave edhe sipas përshkrimit të bërë nga vet operatori Eurovia.
10. Lista e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) nuk dëshmon se Inxhinjeri Sejduallah Pulaj është punëtor i kompanisë nga viti 2013, ashtu siç pretendohet me kontratë të punës. Rrjedhimisht përvoja e tij nuk është e vërtetuar as me listë të projekteve të bashkangjitur në ofertë. Sejduallah Pulaj në asnjë rast nuk dëshmon se ka mbi tri (3) vite e gjashtë (6) muaj përvojë të punës, pas diplomimit të tij.

Autoriteti Kontraktues ka lajthitur operatorët ekonomik në paramasë. Operatori i rekomanduar për kontratë ka bërë ndërhyrje në paramasë dhe rrjedhimisht duhet të konsiderohet i pa përgjegjshëm.

11. Paramasa ka vënë në lajthitje operatorët të cilët kanë ofertuar pasi që formulat e përqindjes në Excel në pjesën e rikalitullimit kanë qenë të ndryshme nga ato në tekstin e paramasës, AK ne e-Prokurim ka vendosur dy paramasa, njëra e datës 18 mars 2019 dhe tjetra e datës 12 prill 2019. Ne kemi mundur që ta shkarkojmë vetëm atë të datës 12 prill 2019.
12. Operatori i rekomanduar për kontratë Eurovia, i ka fshirë formulat e paramasës dhe ka vendosur totalet e pozicioneve me përqindjet e vendosura në tekstin e paramasës. Kjo në fakt është një ndërhyrje në paramasë të dosjes së tenderit, për çka Eurovia duhet të shpallet si operatorë i pa përgjegjshëm.

Prandaj duke u bazuar në të gjitha që u thanë më lartë, Konsorciumi i propozon OShP-së të marrë këtë vendim:

VENDIM

- I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik G-Solutions, G-Project dhe Joos&Krasniqi – Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me

Zhavor për Rugët e Paasfaltuara të Komunës së Prizrenit”, me numër të prokurimit 622-19-1256-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK Prizren.

- II. ANULOHEM, vendimi për dhënien e kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Zhavor për Rugët e Paasfaltuara të Komunës së Prizrenit”, me numër të prokurimit 622-19-1256-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK Prizren dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim

***Shënim:** të gjitha dëshmitë do të dorëzohen në formë fizike, për shkak të volumit të madh të kontratave që do të përdoren si dokumente referente të kompanisë. Eksperti apo sekretariati i OShP mund të na kontaktojnë në numrat e lartshënuar të telefonit apo në email adresë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

I kërkohet Organit Shqyrtues të Prokurimit, që në emër të dëmit të shkaktuar operatorëve në konsorciumin ankues Komuna e Prizrenit të detyrohet që të bëjë pagesën prej:

1. Përgatitja e ofertës së bashku me shpenzimet përcjellëse në vlerë prej EUR 1,000
2. Shpenzimet e përfaqësimit dhe avokatit për përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës në OShP, në vlerë prej EUR 2,500.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OShP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.**

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë.....	21.03.2019
Lloji i procedurës së aplikuar.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar.....	Kontratë publike kornizë, Furnizim
Vlera e parashikuar e kontratës.....	1,500,000.00€
Kriteri për dhënie të kontratës.....	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	30.04.2019
Data e hapjes së ofertave.....	30.04.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....	28.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar	31.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar	31.05.2019
Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës.....	31.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim e OE Renelual Tahiri.....	03.06.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim e OE G-Solutions&G-Project&Joos Krasniqi.....	04.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Renelual Tahiri.....	06.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim të G-Solutions&G-Project&Joos Krasniqi.....	06.06.2019

Kriteret për vlerësim**III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE****III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:**

Kërkesat a). Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65. b)Në dokument nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmeris të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës d një dëshmi se ju keni përmbushë obligimet e tatimit në pronë së paku deri në muajin paraprak nga data e hapjes së ofertave

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr.

05 L-092 .Neni 65. b)Në dokument nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmeris të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës d një dëshmi se ju keni përmbushë obligimet e tatimit në pronë së paku deri në muajin paraprak nga data e hapjes së ofertave

a. Deklarata nën betim e cila është pjesë e DT të plotësohet nënshkruhet dhe vulozet në original b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). D. Vërtetimi i tatimit në pronë Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës.Në rast të dështimit në dorzimë të dokumentave të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 3 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së Kërkesa 4. OE duhet të jetë I licencuar nga AKPMM për ushtrimin e veprimtarisë së gurthyesit Kërkesa 5. OE duhet të jetë i licencuar për shfrytëzim të zhavorrit, nga KPMM

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Certifikata e numrit fiskal Evidenca 3 Qertefikata e TVSH së Evidenca 4. Kopje e licences së lëshuar nga AKPMM për ushtrim të veprimtarisë së gurthyesit. Evidenca 5. Licencë e lëshuar nga KPMM për shfrytëzim të zhavorrit në territorin e Kosovës.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 3,000,000.00 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiar të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.500.000,00€.

Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të emrohet me vendim menaxheri për këtë projekt i cili duhet të jetë Inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite pune në profesion. b.së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike c.4 kamionë të tonazhit të mesëm deri 10 ton d. 2 bagerë gropues të tonazhit të mesëm deri 10 ton e. dy ulta rrafshues i tonazhit të mesëm f. një greder për rrafshim të terrenit I tonazhit të mesëm deri 10 ton g. dy cilindra për ngjeshje, një tonazhit të mesëm deri 10 ton dhe një tonazhit të rëndë mbi 10 ton h. 2 buldozera, një I tonazhit të mesëm deri 10 ton dhe një I tonazhit të madh mbi 10 ton. Vërejtje OE I propozuar për kontratë duhet të sjellë dëshmi se ka në pronësi Gurthyesin ose kontratën e bashkëpunimit me ndonjërin

prej gurthyesve I cili është në një largësi prej jo më shumë se 15 km nga qyteti I Prizrenit., Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, të deshmua me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve. Dëshmija 2 a. Nën pikën a Diploma e fakultetit kopje, referencat për periudhën e kaluar në profesion së paku për 5 vite, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt, b. Nën pikën b Lista e të punësuarve , për stafin e rregullt lista e ATK së bashk me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt. c. pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë librezë të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, pajisjet tjera duhet të sjellë dëshmi mbi pronësinë e tyre ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kërkesa 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.500.000,00€.

Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të emrohet me vendim menaxheri për këtë projekt i cili duhet të jetë Inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite pune në profesion. b. së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike c. 4 kamionë të tonazhit të mesëm deri 10 ton d. 2 bagerë gropues të tonazhit të mesëm deri 10 ton e. dy ulta rrafshues i tonazhit të mesëm f. një greder për rrafshim të terrenit I tonazhit të mesëm deri 10 ton g. dy cilindra për ngjeshje, një tonazhit të mesëm deri 10 ton dhe një tonazhit të rëndë mbi 10 ton h. 2 buldozera, një I tonazhit të mesëm deri 10 ton dhe një I tonazhit të madh mbi 10 ton., Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmua me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve. Dëshmija 2 a. Nën pikën a Diploma e fakultetit kopje, referencat për periudhën e kaluar në profesion së paku për 5 vite, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt, b. Nën pikën b Lista e të punësuarve , për stafin e rregullt lista e ATK së bashk me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt. c. pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë librezë të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, pajisjet tjera duhet të sjellë dëshmi mbi pronësinë e tyre ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi/€	Vërejtje
1.	“Burimi”	Malishevë	580.60€	JO
2.	“EuroVia”	Prizren	20.05€	JO
3.	“Sed Tours”	Prizren	48.35€	JO
4.	“Vëllezërit e Bashkuar”	Prizren	28.79€	JO
5.	“G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi”	Prishtinë	18.20€	JO
6.	“Renelual Tahiri”	Prishtinë	18.95€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Ejup Kryeziu – Kryetar i komisionit
- Përparim Shala – Anëtar i komisionit
- Asim Kokaj – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

- 1). OE Burimi, është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën lidhur me kontratat dhe referencat, nuk ka licencë nga KPMM-ja.
- 2). OE Sed Tours, është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën lidhur me kontratat dhe referencat.
- 3). OE Vëllezërit e Bashkuar, është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën lidhur me kontratat dhe referencat.

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues:

Nr.	Emri i operatorëve ekonomik që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi
1.	EuroVia	Prizren	20.05€

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardh në përfundim se OE ofertues “EuroVia” është i përgjegjshëm dhe të njëjtin e kanë rekomanduar për kontratë, me çmim prej: 20.05€. Rekomandimi i komisionit vlerësues është aprovuar nga Menaxheri i prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE-ve ankues:**Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Renelual Tahiri” - Prizren.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1,500,000.00€.

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, ne dosje te tenderit ka kërkuar lidhur me kontratat dhe referencat ka kërkuar “Projektet e natyrës së kontratës....”.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues “Renelual Tahiri”, ne ofertën e tij ka dorëzuar kontrata dhe referenca në asfaltim te rrugëve, ndërtim te rrugëve, meremetim te rrugëve, ndërtim me elemente te betonit te rrugëve, ne vlerë prej mbi 4,500,000.00€.

Duke u bazuar ne kërkesën e dosjes se tenderit - “Projektet e natyrës së kontratës....”, eksperti shqyrtues, vlerëson se pa u kërkuar sqarime për secilën kontratë te dorëzuar ne ofertë nuk mund te gjendet vlera e saktë e furnizimit me zhavorr apo edhe te pjesëve tjera te përfshira ne paramasë te këtij projekti.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e parashtruara nga OE-të ankues, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara ne Komunën e Prizrenit”, me numër të prokurimit: 622-19-1256-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prizren.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi" - Prizren.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

- Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.500.000,00€.
- Nuk e keni plotësuar në ofertë çmimin e përgjithshëm të peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlere). Në bazë nenit 52 të LPP – së.

Eksperti shqyrtues, sa i përket arsyes se pare te eliminimit ngjashëm sikurse te sqarimi i dhënë me lart konstaton se nuk mund te nxirret vlere e saktë e projekteve te natyrës se kontratës pa e verifikuar saktë listën e kontratave dhe referencave për faktin se edhe OE ankues "G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi", ka ofruar projekte ne ndërtim, asfaltim te rrugëve.

Lidhur me arsyen e dytë te eliminimit, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues nuk e ka plotësuar ne tërësi paramasën dhe parallogarin. Konkretisht OE ankues ne pjesën ku është dashur te jep edhe çmimin e peshuar ne përshkrim te çmimit e ka lënë te zbrazet. Eksperti shqyrtues vlerëson se një situatë e tillë nuk është e përcaktuar me dispozitat e LPP-se, përveç një interpretimi te dhënë ne pyetjen nr. 29 te publikuar ne ueb faqen e Krpp-se, ku thuhet se:

Nëse Operatori Ekonomik nuk plotëson një nga pozicionet në Listën e Përshkrimit të Çmimeve, tenderi duhet të refuzohet, pasi që tenderi gjithmonë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e plotë të kontratës.

OE ankues "G-Solutions &G-Project&Joos Krasniqi", ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontratë, për te cilin pretendon se nuk i ka ofruar pajisjet sipas kërkesave te dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë, konkretisht pretendon se ne dosje jan kërkuar dy cilindra me peshë nen 10t. Ky pretendim nuk qëndron për faktin se ne kërkesë te dosjes se tenderit kërkohej dy cilindra për ngjeshje, një tonazhit të mesëm deri 10 ton dhe një tonazhit të rëndë mbi 10 ton. OE i rekomanduar per kontratë ne ofertën e tij për këtë pajisje i ka dorëzuar dëshmit për cilindrata, por ne shënimet e dhëna thuhet: Kapaciteti 15000, pa e përcaktuar se çka do te thotë 15000, prandaj, eksperti shqyrtues, vlerëson se pajisjet ne fjalë duhet te verifikohen nga AK-ja, konform nenit 72 te LPP-se, se a janë sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë. Poashtu lidhur me pajisjet e ofruara nga i rekomanduari për kontratë, OE ankues pretendon edhe për 4 kamionët dhe 3 buldozheret nuk e plotësojnë kërkesën e AK-se, eksperti shqyrtues, sqaron se edhe te pajisjet lartpërmendura ka paqartësi lidhur me kapacitetin e pajisjeve, dhe bazuar ne faktin se pajisjet kanë paqartësi AK-ja, është dashur ti verifikojte konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se, per faktin se AK-ja, sipas nenit 59 do ta konsideroj te përgjegjshme vetëm ofertën e cila është ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Sa i përket pretendimit te OE ankues lidhur me inxhinierin Sejdullah Pulaj, eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se AK-ja, ka kërkuar ne dosje te tenderit qe "për stafin e rregullt lista e ATK së bashkë me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt", ne kontratën e dorëzuar nga i rekomanduari për kontratë për inxhinierin ne fjalë, kontrata rezulton te jet nga janari i vitit 2019 deri ne fund te vitit 2019, pra me afat te caktuar qe do te thotë se nuk është i angazhuar ne kompaninë "Eurovia" si staf i rregullt.

Eksperti shqyrtues, ne fund te analizimit dhe shqyrtimit te pretendimeve ankimore sqaron se, AK-ja, gjatë vlerësimit te ofertave nuk i ka përdor mundësit ligjore qe i jep LPP-ja, konkretisht nenin 72 dhe 59 te LPP-se, lidhur me sqarimet e kontratave te OE-ve ankues dhe poashtu lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontratë, prandaj, për te nxjerr një përfundim me te saktë është e nevojshme te verifikohen dëshmit e përmendura me lart.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të aprovohen pjesërisht si te bazuar, ndërsa vendimi i AK-se për dhënie të kontratës te anulohet dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.